SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA HAXHIA KUNDËR SHQIPËRISË

(Ankimi nr. 29861/03)

VENDIM

STRASBURG

8 tetor 2013

Ky vendim bëhet i formës së prerë sipas rrethanave të përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet subjekt i redaktimeve.

Në çështjen Haxhia kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e mbledhur në një Dhomë të përbërë nga:

Ineta Ziemele, *presidente*

David Tór Björgvinsson,

George Nicolaou,

Zdravka Kalaydjieva,

Vincent A. De Gaetano,

Paul Mahoney, *gjyqtarë*,

Markelian Koca, *gjyqtar* ad hoc,

dhe Françoise Elens-Passos, *sekretare e Seksionit*

Pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura, më 17 shtator 2013,

Lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë ditë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një ankim (nr. 29861/03) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga një shtetas shqiptar, z. Ismet Haxhia ("ankuesi"), më 20 korrik 2003.

2. Ankuesi përfaqësohej nga z. K. Loloçi, avokat, i cili e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Qeveria shqiptare ("Qeveria") përfaqësohej nga agjenti i saj, znj. L. Mandia e zyrës së Avokatit të Shtetit.

3. Z. Ledi Bianku, gjykatës i përzgjedhur për Shqipërinë, u tërhoq nga çështja (rregulli 28 i rregullores së Gjykatës). Për këtë arsye, Qeveria caktoi z. Markelian Koça në rolin e gjykatësit *ad hoc* në vend të tij (neni 27 § 2 i Konventës dhe rregulli 29 § 1, në fuqi në atë kohë).

4. Bazuar në nenet 5, 6 dhe 7 të Konventës, ankuesi pretendonte se kishte pasur një sërë shkeljesh.

5. Më 28 mars 2006, një Dhomë e Seksionit të Katërt, së cilës iu caktua çështja, vendosi të shqyrtonte ankimin për Qeverinë. Ajo, gjithashtu, vendosi të merrte një vendim mbi pranueshmërinë dhe cilësitë e ankimit në të njëjtën kohë (neni 29 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi ka lindur në vitin 1954 dhe aktualisht po vuan dënimin me burgim, në burgun e Peqinit. Në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet e përshkruara më poshtë, ankuesi ishte kreu i policisë së trafikut në Komisariatin e policisë së Bajram Currit, një qytet në verilindje të Shqipërisë.

A. Realiteti në vend

7. Në vitin 1997, vendi pësoi një shkatërrim total të strukturave institucionale qeveritare, si rezultat i përmbysjes së një sërë skemash të ashtuquajtura "skema piramidale". Armatimet u grabitën nga civilët, rendi publik u shkatërrua totalisht dhe vendi u zhyt në anarki dhe kaos për disa muaj.

8. Në vitin 1998, në njëfarë mënyre, rendi publik u rivendos, por problemet me sigurinë vazhduan, veçanërisht në pjesën verilindore të vendit, duke përfshirë Bajram Currin.

B. Vrasja e një deputeti

9. Më 12 shtator 1998, rreth orës 21:15, z. Azem Hajdari, deputet ("D"), dhe bodigardët e tij, B.C. dhe Z.N., u goditën ndërsa dilnin nga zyrat qendrore të Partisë Demokratike ("PD") në Tiranë. Z. Hajdari dhe B.C. vdiqën në po të njëjtën ditë në spital. Bodigardi i dytë Z.N. ishte dëmtuar rëndë.

10. Z. Hajdari ishte një nga udhëheqësit e PD-së, e cila është një nga dy partitë kryesore politike në Shqipëri, dhe në atë kohë ishte në opozitë. Vrasja e tij shkaktoi një tension të menjëhershëm. Kështu, më 13 shtator 1998, protestuesit u dyndën drejt ndërtesës së Kryeministrisë.

11. Protesta të mëtejshme shpërthyen në Tiranë, gjatë funeralit të të ndjerit, deputetit. Më tej, pasoi një

revoltë e përgjithshme gjatë së cilës, individë të armatosur pushtuan me të shpejtë zyrat qendrore të televizionit shtetëror, Parlamentin dhe godina të tjera të rëndësishme.

12. Situata në Shqipëri ishte tema e rekomandimit nr. 1386 (1998) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, gjatë së cilit Asambleja dënoi rëndë dhunën politike, e cila erdhi pas vrasjes (shiko paragrafin 108 më poshtë).

C. Hetimi penal për vrasjen

13. Pas vrasjes, u ndërmorën një sërë hapash investigativë.

14. U realizuan disa analiza mjekoligjore në skenën e krimit, si dhe u bënë ekzaminimet balistike të një arme automatike dhe një pistolete, të gjetura në vendngjarje. Nuk u bënë autopsi.

15. Në ditët pas vrasjes, policia mblodhi informacion nga pesë dëshmitarë. Rezultoi se një nga dëshmitarët, znj. A.R. pohoi se ajo e kishte parë mjaft mirë vrasësin dhe se mund ta njihte atë. Një dëshmitar tjetër pohoi se kishte parë dy burra të dilnin nga një makinë policie (një Mercedes Benz 250, jeshil), duke qëlluar më pas deputetin dhe bodigardët e tij. Më tej, ai pohoi se një burrë tjetër në vendin e shoferit po priste në parking. Më pas, ai doli për të tërhequr nga vendngjarja deri në makinë, një nga agresorët, i cili ishte plagosur gjatë shkëmbimit të zjarrit.

16. Më 25 shtator 1998, prokurori morri në pyetje Z.N., bodigardin e plagosur, i cili i shpëtoi sulmit. Ai pohoi se kishte parë një person të panjohur, i cili kishte dalë nga sedilja e pasagjerit të një makine me sirenë policie në çatinë e saj, dhe kishte qëlluar me një armë automatike pa paralajmëruar. Nuk u përmend as emri i ankuesit dhe as përfshirja e tij në krim.

17. Në një datë të papërcaktuar, Z.N. u largua nga shteti i tij dhe shkoi në Belgjikë.

18. Më 15 dhjetor 1999, pas një deklarate të publikuar nga z. Sali Berisha, udhëheqësi i PD-së, në të cilën u përmend emri i ankuesit si pjesëmarrës në vrasjen e deputetit, vetë ankuesi, me dëshirën e tij, vendosi të bënte një deklaratë përpara prokurorit. Ai pohoi, *inter alia*, se në ditën e krimit ishte duke ngrënë darkë, vetëm, në një restorant, i cili ndodhej pranë zyrave qendrore të PD-së. Sapo kishte dëgjuar të shtënat, i frikësuar për jetën e të vëllait, ankuesi ishte larguar nga restoranti dhe kishte bërë disa hulumtime. Më pas, ai u kthye përsëri në restorant dhe filloi të diskutonte ngjarjet me A.P. dhe H.A. (shiko paragrafin 72 më poshtë).

19. Në një datë të papërcaktuar në vitin 2000, M., i cili po vuante dënimin me burgim në burgun Regina Celli në Itali, u morr në pyetje nga prokuroria shqiptare. Më 18 shkurt 2000, u urdhërua arrestimi i M. për vrasje nga Gjykata e Rrethit Tiranë ("Gjykata e Rrethit"). Midis deklaratash shumë të paqarta, M. pohoi se ia kishte dhënë makinën e tij vrasësve.

20. Më 26 korrik 2000, M. u morr në pyetje për herë të dytë dhe ai akuzoi tre oficerë të lartë policie nga qyteti i Bajram Currit, se kishin kryer vrasjen. Oficerët ishin përkatësisht: F.M., i cili më herët kishte qenë shefi i Komisariatit të Bajram Currit, J.M., i cili kishte qenë shefi i rendit publik në të njëjtin komisariat policie dhe I.H., i cili kishte qenë bodigardi i mëparshëm i z. Berisha. J.M. dhe I.H. kanë depozituar ankime të veçanta në Gjykatë (*Mulosmani kundër Shqipërisë,* nr. 29864/03 dhe *Izet Haxhia kundër Shqipërisë,* nr. 34783/06). M. nuk e akuzoi ankuesin për përfshirje në vrasje.

21. Më 16 nëntor 2000, me kërkesë të prokurorit shqiptar, një gjykatës investigativ, nga Bruges, mori në pyetje Z.N. Në dëshminë e tij, ai pohoi se kishte parë një njeri të dilte nga pas një Mercedesi të zi. Ai mbante të veshur një jelek antiplumb mbi një uniformë ushtarake, të ngjashme me ato që mbajnë oficerët e policisë, dhe në duar kishte një automatik Kallashnikov, si edhe dy gëzhoja të ngjitura së bashku. Në kundërshtim me deklaratat e bëra në ditët pas vrasjes (shiko paragrafin 16 më sipër), ai aludoi se ai person ishte J.M. Ai pohoi se nuk e njihte ankuesin.

22. Më 20 janar 2001, një kriminel recidivist, i cili po vuante dënimin me burg në Shqipëri, bëri disa deponime përpara prokurorit. Ai kishte ndjekur ngjarjet që çuan në vrasjen e deputetit, nga veranda e katit të parë të një bari, i cili gjendej shumë pranë skenës së krimit. Ai e kishte parë ankuesin në makinën e tij, një Fiat Tipo, përpara se të ndodhte vrasja. Sipas deponimeve të Ç., F.H., J.H. dhe N.C. hapën zjarr ndaj deputetit.

23. Më 6 mars 2001, pas arrestimit të ankuesit (shiko paragrafin 28 më poshtë), prokurori e mori atë në pyetje në prani të avokatit të tij. Ai deklaroi se natën e vrasjes, ai ishte në një hotel afër zyrave qendrore të PD-së. Në momentin e të shtënave, ai po hante darkë në restorantin e hotelit, i shoqëruar nga persona të tjerë. Makina e tij ishte parkuar afër hotelit dhe godinës së PD-së. Ai e mohoi të kishte pasur konflikte të mëparshme me deputetin e vrarë.

24. Më 10 mars 2001, në përputhje me nenin 316 § 1 (b) të Kodit të Procedurës Penale ("KPP"), prokurori i kërkoi Gjykatës së Rrethit të siguronte dëshminë e Ç., i cili pavarësisht se po vuante dënimin me burgim në

Shqipëri, mendohej se rrezikohej të dhunohej. Avokati i ankuesit kërkoi kohë të përgatitej për mbrojtjen. Për këtë arsye, gjykata e shtyu seancën dëgjimore më 11 mars 2001.

25. Më 11 mars 2001, Gjykata e Rrethit përmbushi kërkesën e prokurorit. Ankuesi dhe avokati i tij ndoqën seancën dëgjimore. Dëshmitari Ç. deponoi se nuk kishte marrë kërcënime, dhe se nuk i ishte bërë ndonjë premtim në shkëmbim për paraqitjen e tij në procesin gjyqësor. Fillimisht, ai kishte bërë deponime shumë të kufizuara përpara prokurorit në lidhje me vrasjen nga frika se personat e përfshirë në ngjarje ishin oficerë policie me rekorde kriminale të mëparshme. Në dëshminë e tij, Ç. pohoi se po errësohej dhe ai ishte në verandën e një bari që gjendej në anë të zyrave qendrore të PD-së. Ai pa makinën e ankuesit, por jo ankuesin personalisht. Kur deputeti doli nga zyrat qendrore të PD-së, ai takoi ankuesin dhe të dy patën një debat të nxehtë. Më pas, ai dëgjoi një të shtënë pistolete dhe automatiku. Pas vrasjes, ai pa ankuesin të mbërrinte me një makinë tjetër. Ankuesi pyeti për vrasjen dhe u largua nga skena.

26. Më 12 mars 2001, prokurori shkëputi procedurat penale kundër M. nga procedurat penale kundër ankuesit dhe të bashkëtëpandehurve të tjerë.

27. Më 31 maj 2002, prokurori i hoqi akuzat që rëndonin mbi M. për mungesë provash.

D. Arrestimi i ankuesit

28. Më 13 janar 2001, zyra e prokurorisë lëshoi pesë urdhra arrestesh për pesë oficerë të lartë policie, duke përfshirë edhe ankuesin, mbi dyshimin se mund të ishin përfshirë në vrasjen e deputetit, në vrasjen e bodigardit B.C., si edhe në vrasjen e mbetur në tentativë të bodigardit Z.N.

29. Më 22 janar 2001, ankuesi u arrestua. Ai u ngarkua me akuzën për dy vrasje, sipas neneve 79 (c) dhe 78 të Kodit Penal ("KP") dhe me akuzën e një vrasje të mbetur në tentativë, sipas nenit 78 të KP-së.

30. Më 23 janar 2001, ankuesi u morr në pyetje nga prokurori. Ai u bë me dije për akuzat që rëndonin mbi të dhe për mundësinë që kishte për të caktuar një avokat. Si rezultat, ai kërkoi të përfaqësohej nga një avokat i zgjedhur prej tij. Në po të njëjtën ditë, prokurori kërkoi zbatimin për arrestim të ankuesit.

31. Në seancën dëgjimore të datës 24 janar 2001, ankuesi u përfaqësua nga avokati i tij. Ai pohoi se kishte udhëtuar drejt Tiranës më 11 shtator 1998, për të blerë disa pjesë këmbimi për makinën e tij të biznesit. Në mbrëmjen e 12 shtatorit 1998, ai po hante darkë në një restorant, i cili ndodhej pranë zyrave qendrore të PD-së. Makina e tij ishte parkuar aty afër. Më tej ai pohoi se prokurori nuk kishte dorëzuar asnjë provë që vërtetonte pjesëmarrjen e tij në vrasje. Duke qenë se ai kishte punuar për dy vitet e fundit, nuk kishte rrezik për arratisje. Prokurori parashtroi mendimin se, përderisa hetimi do të vazhdonte për disa kohë, ankuesi do të informohej për faktet kundër tij në kohën e duhur. Gjykata e Rrethit konfirmoi hyrjen në fuqi të vendimit për arrestimin e ankuesit dhe aprovoi ndalimin e tij me burg përpara procesit për një periudhë të papërcaktuar, sepse kishte dyshime të arsyetueshme që ankuesi kishte qenë bashkëpunëtor në vrasjen e deputetit.

32. Më 31 janar 2001, ankuesi dorëzoi një apelim të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë kundër arrestimit të tij, duke argumentuar se prokurori nuk kishte paraqitur prova të mjaftueshme dhe të detajuara.

33. Më 9 shkurt 2001, Gjykata e Lartë mori vendimin se, përderisa Gjykata e Rrethit nuk e kishte vërtetuar rrezikun e një arrestimi, ndalimi fillestar me burgim i ankuesit nuk ishte i ligjshëm. Megjithatë, Gjykata e Lartë mbështeti vendimin që ai të mbetej në gjendje arresti, duke pasur parasysh rrethanat e kryerjes së krimit, rrezikun që krimi paraqiste për rendin publik, si edhe dyshimin se ankuesi kishte bashkëpunuar në realizimin e krimit. Ajo theksoi se vlerësimi i fakteve ishte çështje e cilësive të çështjes.

E. Procedurat e procesit gjyqësor

34. Më 13 mars 2001, prokurori dorëzoi padinë në Gjykatën e Rrethit. Padisë iu bashkëngjit edhe një listë e gjatë me dokumente shtesë. Ankuesi dhe katër të bashkëpandehurit u paditën për pjesëmarrje ose për organizimin e vrasjes së deputetit, si edhe për tentativën për vrasje të civilëve, sipas neneve 78, 79 (c) dhe 25 të KP-së.

35. Më 16 mars 2001, përfaqësuesi i ankuesit mori në dorë dosjen e hetimit, e cila përbëhej nga 324 dokumente dhe 1,409 faqe.

I. Kërkesa e ankuesit

36. Ankuesi parashtroi një sërë kërkesash në procesin gjyqësor.

37. Më 3 prill 2001, avokati i ankuesit kërkoi tridhjetë ditë në dispozicion për të shqyrtuar dokumentet e mbledhura gjatë hetimit penal, sepse prokurori nuk kishte dhënë asnjë informacion në lidhje me hetimin.

38. Më 3 prill 2001, Gjykata e Rrethit, në seancën e saj të parë dëgjimore, pranoi kërkesën e ankuesit për më shumë kohë, deri më 13 prill 2001.

39. Më 13 prill 2001, ankuesi kundërshtoi materialet e pranuara në cilësinë e provës, të cilat përbëheshin

nga disa kaseta audio dhe video, si edhe nga deklaratat e 29 dëshmitarëve, emrat e të cilëve nuk ishin paraqitur në listën e dorëzuar nga prokurori, duke qenë se ai nuk ishte informuar për përmbajtjen e tyre.

40. Më 9 shtator 2001, ai, gjithashtu, kërkoi të bëheshin një sërë ekzaminimesh nga ekspertët: inspektimi i dy makinave, të cilat pretendoheshin se kishin qenë në skenën e krimit, analiza e firmës me shkrim dore të dëshmitarit Ç., si edhe verifikimi se sa e mundur është të kesh një pamje të pastër të një rruge të errët nga një vend i mirëndriçuar, kjo në lidhje me dëshmitarin Ç.

41. Më 17 janar 2002, gjykata i hodhi poshtë kërkesat e ankuesit, pa dhënë ndonjë arsye.

2. Dëshmitë e dëshmitarëve

42. Një sërë dëshmitarësh u morën në pyetje nga gjykata në lidhje me vrasjen, duke përfshirë sa më poshtë:

a) Dëshmitari K.G.

43. Në kohën e vrasjes, dëshmitari K.G. ishte shefi i Komisariatit të policisë së Bajram Currit. Më 23 maj 2001, ai dëshmoi se me t'u lajmëruar për vrasjen në mbrëmjen e 12 shtatorit 1998, ai kishte thirrur në një takim drejtuesit e njësive për të rritur nivelin e sigurisë. Ankuesi nuk ishte i pranishëm.

b) Dëshmitari M.

44. Sipas nenit 509 të KPP-së dhe Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë për Çështjet Penale ("Konventa e Ndihmës së Ndërsjellë"), më 23 maj 2001, prokurori kërkoi që M. të merrej në pyetje me anë të një lidhje me video nga Italia. Ankuesi e kundërshtoi këtë kërkesë për mungesë të bazës ligjore.

45. Më 1 qershor 2001, ankuesi kërkoi përjashtimin nga dosja e çështjes së deklaratave të bëra nga M. gjatë procedurave penale. Gjithashtu, ai kërkoi të ekstradohej nga Italia, në mënyrë që të ishte i pranishëm fizikisht në procesin gjyqësor. U dëgjuan edhe tre dëshmitarë të tjerë.

46. Më 21 shtator 2001, gjykata pranoi kërkesën e prokurorit për të marrë dëshminë e M. me anë të një lidhje me video, në përputhje me nenin 151 § 3 të KPP-së. Gjithashtu, gjykata pranoi që të fuste në dosjen e çështjes deklaratat e M.

47. Më 29 tetor 2001, gjykata dëgjoi M. me anë të një lidhje me video. Në një deklaratë të lëshuar në po të njëjtën ditë, ankuesi dhe një tjetër i bashkëpandehur deklaruan qëllimin e tyre për të mos e ndjekur seancën dëgjimore, duke pasur parasysh mungesën e bazës ligjore për lidhjen me video. Ata nuk i autorizuan avokatët e tyre respektivë t'i përfaqësonin dhe rezervuan të drejtën për të ndjekur seancat e tjera dëgjimore.

48. Gjatë dëshmisë së tij M. nuk pohoi ta kishte parë ankuesin para apo pas vrasjes.

49. Më 3 dhjetor 2001, ankuesi i kërkoi gjykatës të mos e merrte parasysh dëshminë e M. dhe deklaratat e bëra gjatë hetimit penal, për arsye të mungesave teknike dhe kontradiktave në dëshminë e tij.

c) Dëshmitari A.L.

50. A.L. ishte shofer në stacionin policor të Bajram Currit dhe më 8 maj 2001, ai bëri një deponim përpara prokurorit. Sipas pohimeve, A.L. ishte larguar në një mision në Tiranë, vonë në mbrëmjen e 10 shtatorit 1998. Kërkesa ishte bërë nga J.M., i cili ishte shefi i rendit publik. Atij nuk i ishte dhënë asnjë detaj në lidhje me qëllimin e misionit. Ai u shoqërua nga F.H. dhe E.H. gjatë rrugës për në Tiranë, A.L. vuri re një Fiat Tipo pas tyre, edhe pse nuk mund të shihte shoferin e saj. Kur ndaluan në një bar për të pirë diçka, me ta u bashkua edhe N.C. Në atë moment, A.L. vuri re Fiatin t'iu kalonte pranë dhe dalloi shoferin e saj, i cili ishte ankuesi. Me të mbërritur në Tiranë, pas një gjumi të shkurtër në hotel, A.L. nuk pa më as Fiatin dhe as ankuesin në parkingun e hotelit. Ai nuk përmendi, as gjatë 11 shtatorit as në 12 shtator, të kishte parë ankuesin. A.L. u kthye në Bajram Curri në mbrëmjen e 12 shtatorit, i pashoqëruar nga asnjë makinë tjetër.

Deklarata iu paraqit të pandehurit dhe gjykatës në një datë të papërcaktuar në vitin 2001.

51. Më 25 korrik 2001, gjykata dëgjoi dëshminë e A.L. Ankuesi dhe avokati i tij ndoqën seancën dëgjimore dhe i drejtuan pyetje A.L.-së.

52. Sipas dëshmisë së A.L., në mbrëmjen e 10 shtatorit 1998, ai kishte marrë një urdhër nga J.H. të përgatiste një furgon dhe të udhëtonte drejt Tiranës. Ndërsa largohej nga Bajram Curri, ai vuri re se një Fiat Tipo, e cila ishte makina e ankuesit, i ishte bashkuar autokolonës prej tre makinash. Rrugës për në Tiranë, një person i katërt, N.C, ishte bashkuar me ta ndërsa kishin ndaluar për të pirë diçka në një bar. Ankuesi nuk ndaloi. Me të mbërritur në Tiranë, ata shkuan në një hotel-bar, ku ai pa të parkuar makinën e ankuesit. Pasi pushuan për disa orë në një nga dhomat e hotelit, të gjithë vendosën të bënin një xhiro me makinë rreth qytetit, me përjashtim të ankuesit, makina e të cilit nuk dukej më. A.L nuk pohoi ta kishte parë ankuesin më 12 shtator 1998.

53. Më 26 korrik 2001, avokati i të pandehurit u ankua se prokurori nuk e kishte lejuar të përgatiste mbrojtjen e duhur, për pasojë deponimet e A.L. nuk mundën të paraqiteshin më 8 maj 2001. Prokurori u përgjigj se deponimet u paraqitën sapo ishin marrë. Gjithashtu, dëshmitari u thirr në gjyq për të dëshmuar

përpara gjykatës dhe të pyetej nga përfaqësuesi i ankuesit. Sipas prokurorit, A.L. pohoi se nuk e kishte takuar ankuesin në asnjë moment midis 11 dhe 12 shtatorit, por e kishte parë makinën e tij gjatë pushimit, rrugës për në Tiranë, dhe në parkingun e bar-hotelit. Ai nuk e kishte parë makinën të parkuar pranë Sheshit të Ushtarit të Panjohur ditën e krimit. Gjykata kundërshtoi ankesën e të pandehurit.

d) Dëshmitari J.M.

54. Më 27 korrik 2001, J.M., i cili ishte njëri nga të bashkëpandehurit, dëshmoi në gjykatë. Sipas dëshmisë së tij, me kërkesë të F.H, të dy ata së bashku me E.H. u larguan nga Bajram Curri mbrëmjen e 10 shtatorit 1998, në një furgon policie, të drejtuar nga A.L. Duke dalë nga qyteti ata kishin vënë re ankuesin, i cili ngiste një makinë tjetër. Kur arritën në Tiranë, ankuesi mori një drejtim tjetër, për t'u marrë me disa çështje personale.

55. Më 30 korrik 2001, J.M u rimorr në pyetje nga të gjitha palët.

e) Dëshmitarja P.G.

56. P.G. dëshmoi më 20 shtator 2001. Edhe pse ishte dëshmitare okulare e vrasjeve, ajo nuk përmendi të kishte parë ankuesin në skenën e krimit.

f) Dëshmitari Ç.

57. Më 13 qershor 2001, ankuesi i kërkoi gjykatës të mos e pranonte dëshminë e Ç. të dhënë më 11 mars 2001. Duke qenë se nuk kishte asnjë pengesë ligjore që Ç. të paraqitej në procesin gjyqësor, dhe duke qenë se deponimet e tij implikonin drejtpërsëdrejti ankuesin dhe të bashkakuzuarit e tjerë, ai kërkoi që Ç. të thirrej për të dëshmuar në gjykatë. Më vonë u zbulua se nuk ishte marrë asnjë vendim nga gjykata.

58. Më 9 nëntor 2001 dhe 20 shkurt 2002, pas kërkesës së bërë, gjykata nuk i dha të drejtën të pandehurit të ndërmerrte veprime investigative, duke përfshirë edhe një kontroll, nëse ka qenë e mundur që Ç. të shikonte në errësirë nga një vend i ndriçuar mirë, në një distancë prej 60/150 metrash.

59. Më 17 janar 2002, gjykata nuk e pranoi kërkesën e të pandehurit për realizimin e një ekspertize për të vërtetuar se sa i aftë ka qenë Ç. për të parë detajet në skenën e krimit.

60. Më 24 janar 2002, avokati i të pandehurit kërkoi të thërritej Ç. për të dëshmuar. Gjykata e kundërshtoi këtë kërkesë, duke qenë se dëshmia e tij ishte marrë më 11 mars 2001. Megjithatë, më 18 shkurt 2002, gjykata e rishikoi këtë vendim dhe thirri Ç. të paraqitej në gjykatë.

61. Më 20 shkurt 2002, Ç. dëshmoi. Ai pohoi se rreth orës 9:00 të mbrëmjes, të datës 12 shtator 1998, ai ishte ulur në verandën e një bar-kafeje, 60 metra larg skenës së krimit. Pavarësisht faktit se jashtë ishte tërësisht errësirë dhe po binte shi, ai pa të pandehurin dhe makinën e tij me disa persona të tjerë brenda. Ankuesi vuri në dyshim besueshmërinë e deponimeve të bëra nga Ç. deri në ato momente, për faktin se deponimet e tij përfshinin persona dhe makina, të cilat nuk ishin përshkruar nga dëshmitarët e tjerë në skenën e krimit. Kërkesa e ankuesit për të testuar se sa i aftë ishte Ç. të shikonte nga një verandë e ndriçuar mjaft mirë, në një rrugë të errët, u kundërshtua përsëri nga gjykata (shiko edhe paragrafët 41, 58 dhe 59 më sipër), e cila pohoi se kjo e dhënë do të shqyrtohej së bashku me provat e tjera.

62. Në një datë të papërcaktuar, u morr në pyetje pronari i kafenesë ku Ç. ishte ulur mbrëmjen e 12 shtatorit 1998. Ai pohoi se atë ditë, kafeneja u mbyll si zakonisht në orën 19:00. Veranda ndodhej rreth 200 metra larg nga skena e krimit.

g) Dëshmitari Z.N.

63. Në një datë të papërcaktuar, gjykata mori materialet e përgatitura me shkrim nga Z.N., i cili u plagos rëndë ditën e vrasjes. Ai nuk përmendte nëse ankuesi ishte i pranishëm në skenën e krimit.

h) Dëshmitarët E.B., A.P. dhe H.A.

64. Më 24 dhjetor 2001, dëshmitarët E.B, A.P. dhe H.A. dëshmuan se në kohën e të shtënave, ata po hanin darkë në një restorant afër skenës së krimit.

i) Dëshmia e ankuesit

65. Më 5 mars 2002, ankuesi përgatiti disa materiale të detajuara në lidhje me lëvizjet e tij në datat 11 dhe 12 shtator 1998. Ai pohoi se, me kërkesë të eprorit të tij, ai u largua vetëm nga Bajram Curri herët në mëngjesin e 11 shtatorit 2001. Në kundërshtim me pohimet e A.L., ai nuk e dinte se J.M. ishte nisur për në Tiranë në po të njëjtën ditë. Ai nuk e pranoi se kishte qenë në hotel në mëngjesin e 11 shtatorit, siç kishte deklaruar A.L.

66. Më 8 mars 2002, ankuesi dëshmoi. Ai pohoi se më 10 shtator 1998, mori disa udhëzime me gojë, për të shkuar në një mision në Tiranë. Megjithatë, nuk u përgatit asnjë autorizim apo urdhër me shkrim. Ai u largua nga Bajram Curri në orën 2 të mëngjesit, të datës 11 shtator 1998, vetëm, me makinën e tij. Po ta kishte ditur

se J.M dhe tre persona të tjerë po udhëtonin në një automjet tjetër, do të ishte bashkuar me ta, duke pasur parasysh situatën e paqëndrueshme në rajon në atë kohë. Ai nuk kishte qenë kurrë në një bar-hotel, siç pretendonte A.L. Ndërsa në lidhje me praninë e tij në funeralin e N.C., ai thjesht po shoqëronte F.H. dhe E.H. me kërkesë të F.H.

3. Parshtrimet përfundimtare të palëve

67. Më 18 mars 2002, gjykata kërkoi parashtrimet përfundimtare të palëve. Në po të njëjtën ditë, prokurori bëri parashtrimet e tij përfundimtare në favor të dënimit të ankuesit, siç edhe ishte akuzuar ky i fundit.

68. Më 10 prill 2002, ankuesi bëri parashtrimet e tij të fundit.

4. Vendimi i Gjykatës së Rrethit i datës 29 prill 2002

69. Më 29 prill 2002, Gjykata e Rrethit shpalli vendimin. Ajo konstatoi se ankuesi kishte ndihmuar dhe mbështetur autorët e krimit, duke i shoqëruar natën e 10 shtatorit 1998 me makinën e tij të policisë. Makina e tij ishte parkuar pranë skenës së krimit natën e 12 shtatorit 1998, dhe ai ishte parë në skenën e krimit pas kryerjes së krimit. Edhe pse ishte në dijeni se F.H. kërkohej nga policia, ai vazhdoi të mbante kontakte me F.H. dhe vëllanë e tij, dhe më pas u pa edhe në funeralin e N.C., përfshirja e tij në organizimin e krimit u vërtetua nga dëshmitarët A.L., K.G dhe J.M. Dëshmitarët e ankuesit nuk kishin asnjë dyshim për ato përfundime. Vendimi interpretohet si më poshtë:

"Një tjetër person, i cili mori pjesë në realizimin e krimit, është i akuzuari Ismet Haxhia.

Një sërë veprimesh, të cilat nisën …. me shoqërimin e skuadrës nga Bajram Curri në Tiranë, dhe më tej në hotel "Murati", ku skuadra u akomodua pasditen e 11 shtatorit 1998, praninë e tij në skenën e krimit … së bashku me makinën e tij Fiat Tipo …, si edhe me praninë e tij në familjen e N.C., 40 ditë pas vdekjes së tij, krijojnë bindjen për gjykatën se ai ka qenë bashkëpunëtor, ndihmës në kryerjen e krimit.

Pjesa e mësipërme provohet me anë të të dhënave të dëshmitarit A.L., i cili ishte i pranishëm në ato ngjarje; me dëshminë e K.G., i cili pohoi se Ismet Haxhia … nuk kishte marrë leje të shkonte në Tiranë më 11 dhe 12 shtator.

Prania e tij në ngjarjet e mësipërme provohet edhe me anë të dëshmisë së të bashkëpandehurit J.M.

Tërësia e këtyre veprimeve, si elemente të *actus reus* të krimit, e çuan gjykatën në përfundimin se i akuzuari Ismet Haxhia është bashkëpunëtor, ndihmës në realizimin e krimit.

Dëshmitarët e thirrur nga i akuzuari nuk e mohuan apo e vunë në dyshim praninë e tij në ato ngjarje, të cilat kishin lidhje me përgatitjen, realizimin dhe zhvillimet që ndodhën më pas."

70. Gjithashtu, gjykata besonte se deputeti nuk u vra për arsye politike, por për hakmarrje, pasi mendohej se ai ishte përfshirë në vrasjen e vëllait të F.H. për pasojë, gjykata i riklasifikoi akuzat kundër ankuesit si vrasje e paramenduar e realizuar për hakmarrje, sipas nenit 78 § 2 të KP-së, i cili hyri në fuqi më 24 janar 2001. Vendimi interpretohet si më poshtë:

"Prokuroria e riklasifikoi vrasjen në përputhje me nenin 79 (c), duke e lidhur me faktin se gjatë një seance parlamentare, deputeti i vrarë kishte akuzuar F.H. për vrasjen (e një polici).

Në këto rrethana, (prokurori) përcaktoi se motivi për vrasjen e deputetit kishte qenë pozicioni i tij si deputet. Megjithatë, provat e sjella në procesin gjyqësor, rrethanat dhe ngjarjet që çuan në vrasjen e deputetit vërtetojnë se vrasja është kryer për motivet e dobëta të hakmarrjes."

71. Në lidhje me vendimin për dy të bashkëpandehurit, gjykata i kundërshtoi dëshmitë e dëshmitarëve Ç. dhe M. si kontradiktore dhe të pabesueshme. Gjithashtu, gjykata e shpalli J.M. të fajshëm, si edhe më herët.

72. Gjykata e Rrethit e shpalli ankuesin fajtor për ndihmën e ofruar dhe bashkëpunimin në vrasjen e deputetit, sipas neneve 78 § 2 dhe 25 të KP-së dhe e shfajësoi nga akuzat për vrasjen e B.C. dhe vrasjen e mbetur në tentativë të Z.N. ankuesi u dënua me 20 vjet burg. Vendimi interpretohet si më poshtë:

"Siç u përmblodh edhe nga prokurori, në këtë çështje ekziston vetëm një bashkëpunim i thjeshtë dhe jo një skemë me role, detyra, objektiva dhe plane (të përcaktuara). Në këtë bashkëpunim, mbështetësi dhe ndihmësi … Ismet Haxhia ka knotribuar në mënyra të ndryshme, por gjithmonë për të vetmin qëllim për të vrarë Azem Hajdarin.

Nëse nuk provohet se ka ekzistuar një plan i detajuar midis bashkëtëpandehurve dhe individëve të tjerë, të cilët nuk jetojnë më, ose se ka ekzistuar një marrëveshje verbale, duke përcaktuar kështu rolin e gjithsecilit për përmbushjen e qëllimit final … i pandehuri Ismet Haxhia nuk mund dhe nuk duhet të bëhet përgjegjës për veprimet e autorit të krimit. Duke mos qenë i lidhur me (ekzistencën e) një skemë të përcaktuar dhe duke mos qenë autori i vrasjes së paramenduar, Ismet Haxhia duhet të jetë përgjegjës vetëm për (ndihmën dhe mbështetjen e ofruar në) vrasjen e paramenduar të Azem Hajdarit."

5. Procedurat kundër mungesës së paanshmërisë së Gjykatës së Rrethit

73. Më 29 tetor 2001, në orën 10:00 të mëngjesit, ankuesi dhe një tjetër bashkëipandehur pohuan përpara Gjykatës së Apelit Tiranë ("Gjykata e Apelit"), se banka e Gjykatës së Rrethit nuk ishte e paanshme. Ata pretenduan se ky fakt ishte demonstruar me hedhjen poshtë të të gjitha mocioneve të tyre dhe me pranimin e fakteve të marra në mënyrë të paligjshme, si p.sh. dëshmia e M. (shiko paragrafin 47 më sipër).

74. Në po të njëjtën ditë, në mungesë të ankuesit dhe të përfaqësuesit të tij, por në prani të prokurorit, Gjykata e Apelit e hodhi poshtë kërkesën, me pretendimin se kjo e fundit kishte të bënte me vlerësimin e fakteve, të cilat do të

shqyrtoheshin gjatë çdo apelimi të bërë kundër dënimit.

75. Më 9 nëntor 2001, ankuesi apeloi kundër vendimit në Gjykatën e Lartë. Dokumenti i dorëzuar i apelimit mban datën 13 nëntor 2001 dhe ka vulën e gjykatës, sipër në cepin e djathtë.

76. Më 14 janar 2002, ankuesi pyeti për apelimin e tij në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Rrethit u përgjigj se Gjykata e Lartë nuk kishte bërë asnjë kërkesë për transferimin e dosjes së çështjes për shqyrtim.

77. Apelimi nuk u shqyrtua kurrë nga Gjykata e Lartë, por iu referua vendimit të tij të datës 14 shkurt 2003 (shiko paragrafin 87 më poshtë).

F. Procedurat e Gjykatës së Apelit

1. Procedurat përpara Gjykatës së Apelit

78. Më 7 maj 2002, ankuesi paraqiti një apelim kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit. Ai pohoi se prokurori kishte paraqitur padinë dhe e kishte transferuar dosjen e gjyqit pa treguar më parë asnjë nga dokumentet. Gjykata nuk i kishte dhënë kohë të mjaftueshme për të shqyrtuar dokumentet mbi të cilat prokurori mbështeste akuzat. Mosnxjerrja në kohë e deponimeve të A.L., të datës 8 maj 2001, e penguan atë të përgatiste mbrojtjen e duhur; në dëshminë e tij A.L. thjesht kishte pohuar se gjatë rrugës për në Tiranë kishte parë makinën e ankuesit ta parakalonte. Më tej, ai e kontestoi mënyrën në të cilën ishte marrë dëshmia e M., si edhe mungesën e M. në seancën dëgjimore.

Më tej, ankuesi shprehu pakënaqësinë se vendimi i Gjykatës së Apelit i datës 29 tetor 2001, ishte marrë në mungesën e tij dhe se ai shkelte parimin e procedurave kundërshtuese (shiko paragrafin 74 më sipër). Apelimi i tij kundër atij vendimi ishte ende i pazgjidhur në Gjykatën e Lartë. Sipas ankuesit, gjykata nuk i dha peshën e duhur dëshmive të dëshmitarëve, të cilat vërtetonin se ai po hante darkë në një restorant aty afër kur u vra deputeti (shiko paragrafin 64 më sipër). As dëshmitarët okularë P.G., Z.N. dhe S.L. nuk deklaruan se e kishin parë në skenën e krimit ose se kishin parë një makinë policie të parkuar aty pranë. Në kundërshtim me interpretimin e veprimeve të tij nga ana e gjykatës, nuk kishte asnjë element të dukshëm kriminal, në faktin se dy ditë përpara vrasjes, ai kishte udhëtuar me njerëzit, të cilët më vonë vranë deputetin, dhe as në faktin se kishte marrë pjesë në funeralin e N.C., dyzet ditë pas vrasjes; dhe as në faktin se pesëmbëdhjetë vjet më parë kishte njohur vëllanë e F.H. Vendimit të gjykatës i mungonin arsyet për të provuar rolin e tij si ndihmës, bazuar në nenin 26 të KP-së.

79. Në seancën dëgjimore të datës 8 korrik 2002, ankuesi dorëzoi një përmbledhje të plotë të fakteve dhe bëri një listë të detajuar me kërkesa për Gjykatën e Apelit; specifikisht: pranimin e fakteve, ndërmarrjen e veprimeve të tjera hetuese dhe marrja në pyetje e disa dëshmitarëve të tjerë.

80. Më 9 korrik 2002, Gjykata e Apelit pranoi si fakte një sërë dokumentesh sipas kërkesës së ankuesit dhe kundërshtoi pjesën tjetër të kërkesave të tij. Në po të njëjtën datë, ajo mbështeti plotësisht vendimin e Gjykatës së Rrethit. Gjykata e Apelit theksoi veçanërisht vendimin se ankuesi kishte marrë pjesë si ndihmës në kryerjen e krimit. Për shembull, ai kishte shoqëruar autorët e krimit nga Bajram Curri në Tiranë dhe anasjellas, ishte parë në hotel, makina e tij ishte parkuar afër skenës së krimit, ishte shok i ngushtë i H.H., i cili ishte vëllai i F.H., dhe ishte parë të shkonte për vizitë në familjen e N.C., 40 ditë pas vdekjes së tij. Roli i tij u përcaktua bazuar në dëshmitë e të bashkëpandehurit J.M., të dëshmitarëve A.L. dhe L.G., si edhe të dëshmitarëve të tjerë. Dëshmitarët e ankuesit nuk ngritën dyshime për praninë e tij gjatë ngjarjeve të sipërpërmendura.

81. Gjykata e Apelit mbështeti edhe dënimin për J.M.

2. Procedurat përpara Gjykatës së Lartë

82. Më 31 korrik 2002, J.M., një nga të bashkëpandehurit, apeloi në Gjykatën e Lartë, duke argumentuar *inter alia* se gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk kishin fuqinë të riklasifikonin akuzat kundër tij.

83. Më 5 gusht 2002, ankuesi paraqiti një apelim në Gjykatën e Lartë, duke mbështetur të njëjtin apelim të dorëzuar përpara Gjykatës së Apelit, dhe me shtesën se vendimi i Gjykatës së Apelit nuk ishte gjykuar drejtë. Dënimi i tij ishte bazuar në fakte rrethanore në vend të fakteve që të mund të vërtetonin veprime konkrete të jashtëligjshme të kryera nga ai.

84. Më 14 shkurt 2003, Gjykata e Lartë mbështeti vendimin e gjykatave të shkallëve më të ulëta.

85. Gjykata e Lartë konstatoi se, pavarësisht faktit se në dosjen e çështjes nuk kishte pasur një vendim formal për të mbyllur fazën hetuese dhe për të paraqitur dokumentet e mbledhura gjatë hetimit penal ndaj ankuesit dhe të bashkëpandehurve të tjerë, më 3 prill 2001, Gjykata e Rrethit e kishte pranuar kërkesën e ankuesit për më shumë kohë dhe i kishte dhënë kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.

86. Gjykata e Lartë konstatoi se deponimet dhe dëshmia në video e M. ishin marrë në bazë të neneve 151 § 3 dhe 509 të KPP-së, si edhe në bazë të Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë. Deklaratat e M. gjatë hetimit

penal ishin bërë subjekt i një ekzaminimi ligjor me anë të një lidhje me video. Fakti se ankuesi ishte larguar nga seanca dëgjimore nuk e bënte nxjerrjen e fakteve të paligjshme, duke pasur parasysh praninë e të bashkëpandehurve të tjerë dhe të avokatëve të tyre, të cilët kishin ushtruar të drejtën ta rimerrnin në pyetje M. Pasi Gjykata e Lartë dënoi sjelljen e ankuesit në seancën dëgjimore, ajo thirri trupën gjyqësore për t'u siguruar që në të ardhmen të siguroheshin avokatë të përcaktuar nga gjykata në mënyrë që të garantohej mbrojtja e të drejtave të palës mbrojtëse.

87. Gjykata e Lartë theksoi se dosja e çështjes përmbante një kopje të apelimit të ankuesit më 9 shtator 2001 (shiko paragrafin 75 më sipër), por ajo vendosi se apelimi nuk ishte dorëzuar në përputhje me kërkesat ligjore (në regjistrin e gjykatës nuk kishte asnjë shënim për datën e prezantimit të tij).

88. Fakti se ankuesi dhe bashkëtëpandehurit nuk kishin marrë më herët një kopje të deklaratës së dëshmitarit A.L., nuk shkel të drejtat e tyre për mbrojtje: A.L. kishte dëshmuar në procesin gjyqësor me kërkesë të ankuesit dhe ankuesi nuk kishte pasur mundësi ta pyeste atë.

89. Në përgjigje të ankesës së ngritur nga i bashkëpandehuri J.M., Gjykata e Lartë konstatoi se riklasifikimi i akuzave nga gjykata kundër ankuesit ishte në përputhje me ligjin, më konkretisht neni 375 i KPP-së, i cili ka hyrë në fuqi më 13 qershor 2002.

90. Gjykata e Lartë theksoi se, ndërsa ankuesi ka të drejtën të kërkojë rihapje të ekzaminimit ligjor, është e drejta e gjykatës të mbledhë fakte shtesë. Në këtë rast, Gjykata e Apelit kishte pranuar si fakte një sërë dokumentesh dhe kishte hedhur poshtë pjesën e mbetur të mocioneve të ankuesit me pretendimin se ato ishin të panevojshme për ekzaminimin e çështjes.

91. Në fund, Gjykata e Lartë hodhi poshtë pjesën e mbetur të ankesave të të pandehurit me pretendimin se ato kishin të bënin me vlerësimin e fakteve, çka është një funksion i kryer nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

3. Procedurat përpara Gjykatës Kushtetuese

92. Në një datë të paspecifikuar, ankuesi paraqiti një apelim kushtetues përpara Gjykatës Kushtetuese. Ai pretendonte se arrestimi i tij i parë nuk ishte bazuar në ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm dhe se ai nuk ishte informuar siç duhej për arsyet e atij arrestimi. Më tej ai pretendonte se nuk kishte pasur mjaftueshëm kohë për të studiuar informacionin voluminoz në dosjen e hetimit penal, e cila i ishte dorëzuar gjykatës. Sipas tij, disa nga faktet janë siguruar në mënyrë të paligjshme: dëshmia e M. nuk është marrë nga Ministria e Drejtësisë, siç parashikohet në nenin 509 të KPP-së, duke qenë se Konventa për Ndihmë të Ndërsjellë kishte hyrë në fuqi në një datë të mëvonshme për Shqipërinë; dëshmia e M. ishte marrë në mungesë të ankuesit; dëshmia e Ç. ishte marrë me shumë nxitim në një ditë të diel, pa e informuar plotësisht ankuesin për arsyet; dhe deklaratat e J.M. dhe A.L. të datës 6 dhe 8 maj 2001 respektivisht, u morën pas konkluzionit të hetimit penal, në shkelje të ligjit vendas (neni 324 § 4 i KPP-së).

93. Ankuesi parashtroi pakënaqësinë se të gjitha kërkesat e tij për raporte të përgatitura nga ekspertët apo për të thirrur dëshmitarë ishin kundërshtuar me pa të drejtë nga gjykata. Gjykata e Apelit nuk kishte mundur të jepte arsye për refuzimin e kërkesës së tij për të siguruar disa fakte. Ankuesi ishte i pakënaqur, duke pretenduar për mungesë paanshmërie nga ana e gjykatave vendase, duke iu referuar veçanërisht vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 29 tetor 2001, i cili ishte marrë në një procedurë shumë të shpejtë, brenda dy orëve në mungesë të tij apo të përfaqësuesve përkatës. Fakti që Gjykata e Lartë nuk e shqyrtoi apelimin e tij përbën shkelje të nenit 2 të protokollit nr. 7 të Konventës. Dënimi i tij nuk u arsyetua dhe u bazua në fakte rrethanore (udhëtimi në Tiranë së bashku me autorët e krimit, të darkuarit 200 metër larg nga skena e krimit në ditën e krimit, prezenca në funeralin e N.C., dyzet ditë pas krimit dhe miqësia e tij me të vëllanë e autorit të krimit (H.H.) dhjetë vjet përpara se të ndodhte krimi).

94. Edhe J.M apeloi në Gjykatën Kushtetuese duke argumentuar, *inter alia*, se gjykatat e shkallëve më të ulëta i kishin tejkaluar kompetencat e tyre kur kishin riklasifikuar akuzat penale kundër tij.

95. Më 9 korrik 2003, Gjykata Kushtetuese, e mbledhur në një formacion të plotë prej nëntë gjyqtarësh, e deklaroi apelimin të papranueshëm me pretendimin se apelimi nuk përbënte shkelje të së drejtës për një proces gjyqësor të drejtë.

II. LIGJET VENDASE DHE NDËRKOMBËTARE TË LIDHURA ME ÇËSHTJEN

A. Kodi Penal

96. Neni 26 § 5 parashikon se ndihmësit janë persona, të cilët me anë të këshillave të tyre, udhëzimeve, mjeteve, ngritjes së pengesave, premtimeve për të fshehur bashkëfajtorët e tjerë, gjurmët ose objektet që janë të lidhura me aktin kriminal; ndihmojnë në realizimin e këtij akti.

97. Në kohën e realizimit të krimit, neni 78, i amenduar në vitin 1996, parashikonte se vrasja me paramendim kërkonte një dënim me burgim të përjetshëm. Neni 79 (c), i cili ka të bëjë me aktin kriminal të

vrasjes me qëllim, për shkak të pozicionit të viktimës, parashikonte burgim të përjetshëm.

98. Sipas ligjit nr. 8733 të datës 24 janar 2004, nenet 78 dhe 79 (c) ndryshuan si më poshtë:

Neni 78 – Vrasje me paramendim

"1. Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet.

2. Vrasja e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm."

Neni 79: Vrasje me dashje për shkak të pozicionit të viktimës

"Vrasja me dashje e kryer ndaj: ….

c) një deputeti, gjyqtari, prokurori, avokati, polici, ushtaraku, funksionari tjetër publik, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura;

dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm".

B. Kodi i Procedurës Penale

99. Neni 50 § 1 konstaton se një avokat i ushtron të drejtat pasi ka rënë dakord me të pandehurin ligjërisht, nëse ligji nuk ia ka rezervuar këtë të drejtë vetëm të pandehurit. Sipas nenit 51 § 1 një avokat, me pëlqimin e të pandehurit, mund të caktojë një zëvendësues për aq kohë sa atij i ndalohet të ndjekë procesin gjyqësor.

100. Neni 151 § 3 i jep të drejtën gjykatës të mbledh të dhëna për të cilat nuk ka ndonjë parashikim ligjor regullator, nëse ato shërbejnë për të vërtetuar faktet dhe nëse ato nuk kufizojnë vullnetin e lirë të individit.

101. Nenet 316-322 përcaktojnë se institucioni duhet të sigurojë të dhëna gjatë fazës së hetimit penal. Palët mund të kërkojnë që të sigurohen të dhënat, p.sh.: deklaratat e një dëshmitari, procesi i identifikimit, raporti i një eksperti, kur ka arsye të besohet se në të ardhmen ato nuk do të lejohen të mbledhin këto të dhëna.

Kërkesa duhet t'i dorëzohet me shkrim zyrës së regjistrimit të gjykatës. Sigurimi i këtyre të dhënave ndodh në seancën dëgjimore në prani të palëve.

102. Neni 375, siç ishte në fuqi në kohën kur u miratua vendimi i Gjykatës së Rrethit, përcaktonte se gjykata informon palët për një riklasifikim të ri ligjor që mund t'u bëjë fakteve, ndryshe nga ai i dhënë nga prokurori, nëse akti kriminal është brenda kompetencave të saj. Neni 375, i amenduar më 13 qershor 2002, përcakton se "në vendimin e saj përfundimtar, gjykata mund t'i japë faktit një riklasifikim (të ri) ligjor, të ndryshëm nga ai i bërë nga prokurori …, më i butë apo më i ashpër, nëse akti kriminal është brenda kompetencave të saj".

103. Sipas nenit 324 § 4, aktet hetuese të ndërmarra pas përfundimit të afatit kohor për të nxjerrë konkluzionet e hetimit penal, nuk mund të jenë të besueshme në procesin gjyqësor.

104. Neni 407 § 5 përcakton se në rast se është dorëzuar një apelim në gjykatën e gabuar, kjo e fundit duhet ta dërgojë te gjykata kompetente. Neni 413 § 1 përcakton se një apelim duhet të dorëzohet në zyrën e regjistrimit të gjykatës, e cila ka dhënë vendimin. Sekretari i gjykatës shënon në apelim, *inter alia*, datën e marrjes së tij. Sipas nenit 415 § 1 afati kohor për dorëzimin e një apelimi është 10 ditë. Afati kohor fillon që nga dita pas shpalljes së vendimit.

105. Sipas nenit 427, Gjykata e Apelit mund të përsërisë shqyrtimin gjyqësor të çështjes. Në rast se njëra nga palët kërkon rishqyrtimin e fakteve të administruara gjatë procedurave të gjykatës së shkallës së parë, ose kërkon mbledhjen e të dhënave të reja shtesë, Gjykata e Apelit, kur ta shikojë të arsyeshme, mund të vendosë të rihapë procedurat gjyqësore pjesërisht ose plotësisht (neni 427 § 1). Për aq fakte sa dolën në dritë pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë; apo për aq fakte sa dolën në dritë gjatë procedurave të apelimit, Gjykata e Apelit vendos t'i pranojë ato veç e veç (neni 427 § 2). Rishqyrtimi i çështjes mund të vendoset *ex officio* kur të shikohet e nevojshme (neni 427 § 3). Gjykata e Apelit mund t'i rishikojë faktet duke qenë se ankuesi nuk ishte i pranishëm gjatë procedurave të shkallës së parë, ose sepse nuk ishte njoftuar, ose sepse nuk ishte në gjendje t'i ndiqte ato procedura në mënyrë të ligjshme (neni 427 § 4).

106. Neni 509-511 do të merret në konsideratë gjatë procedurës për dërgimin e letër-porosive dërguar me anë të Ministrisë së Drejtësisë.

C. Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale ("Konventa e Ndihmës së Ndërsjellë")

107. Konventa për Ndihmë të Ndërsjellë hyri në fuqi për Shqipërinë më 3 korrik 2000. Ajo përcakton rregulla të përbashkëta në fushën e ndihmës së ndërsjellë për çështjet penale, si për shembull, marrja në pyetje e dëshmitarëve apo e ekspertëve. Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë janë bërë me anë të letër-porosive, të cilat duhet të dërgohen nga Ministria e Drejtësisë e palës që bën lutjen për te Ministria e Drejtësisë e palës së kërkuar.

D. Rekomandimi 1386 (1998) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës

108. Vendimi në lidhje me çështjen interpretohet si më poshtë:

"5. Asambleja dënon ashpër vrasjen e parlamentarit të Partisë Demokratike, Azem Hajdarit dhe bodigardit të tij. Autoritetet duhet t'i vërtetojnë komunitetit ndërkombëtar se po bëjnë çdo përpjekje të nevojshme t'i nxjerrin përgjegjësit përpara drejtësisë sa më shpejtë të jetë e mundur dhe të lejojnë kryerjen e një hetimi të pavarur ndërkombëtar.

6. Më tej, Asambleja dënon ashpër dhunën politike të të dyja anëve, e cila erdhi menjëherë pas këtyre vrasjeve. Sulmet në institucionet demokratike të shtetit nuk mund të justifikohen në asnjë këndvështrim politik. Çdo përpjekje për të marrë pushtetin me forcë është qartësisht e papranueshme (…)".

LIGJI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENEVE 5 §§ 1 DHE 2 TË KONVENTËS

109. Ankuesi shprehu pakënaqësitë e tij sipas nenit 5 §§ 1(c) dhe 2, duke pretenduar se ndalimi i tij me burgim nuk ishte bazuar në dyshime të arsyeshme dhe se ai nuk ishte informuar siç duhej dhe mjaftueshëm për arsyet e arrestimit të tij. Neni 5 §§ 1 (c) dhe 2 të Konventës përshkruajnë si më poshtë:

"1. Çdo njeri ka të drejtën për të qenë i lirë dhe i sigurt. Asnjë nuk duhet të privohet nga liria e tij, me përjashtim të çështjeve të mëposhtme dhe në përputhje me një procedurë të përshkruar nga ligji:

c) arrestimi i ligjshëm ose ndalimi me arrest i një personi me arsyen për ta nxjerrë përpara autoritetit ligjor kompetent bazuar mbi një dyshim të arsyeshëm për kryerjen e një krimi ose kur konsiderohet si i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një krimi apo arratisjen pasi është kryer krimi.

2. Çdo individ që arrestohet duhet të informohet me përpikëri, në gjuhën që ai kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe për çdo akuzë kundër tij."

110. Gjykata përsërit se ajo "mund të merret vetëm me (një) çështje … brenda një periudhe gjashtëmujore nga data në të cilën është marrë vendimi përfundimtar" (shiko, midis të tjerave, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, nr. 20134/05, § 139, 7 shkurt 2012; dhe *Paul dhe Audrey Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.) nr. 46477/99, 7 qershor 2001).

111. Duke iu kthyer fakteve të çështjes në fjalë, gjykata vëren se ankuesi e kundërshtoi ndalimin e tij fillestar me burgim përpara autoriteteve vendase. Vendimi përfundimtar vendas, në lidhje me ato procedura, ishte vendimi i Gjykatës së Lartë më 9 shkurt 2001. Ankuesi paraqiti pakënaqësinë e tij në këtë Gjykatë më 20 korrik 2003. Doli si konkluzion se ankesa e tij u paraqit jashtë limitit kohor prej gjashtëmuajsh dhe duhej të kundërshtohej në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 §§ 1 DHE 3 TË KONVENTËS

112. Sipas nenit 6 § 1 të Konventës, ankuesi paraqiti një sërë ankesash. Fillimisht, ai u ankua se vendimet e gjykatave vendase nuk kishin mjaftueshëm arsye. Së dyti, ato gjykata kishin pranuar fakte, të cilat ishin përvetësuar në mënyrë të paligjshme, si për shembull, dëshmia e M. me anë të një lidhje me video. Së treti, bankës së Gjykatës së Rrethit, ashtu si edhe bankës së Gjykatës së Lartë më datë 14 shkurt 2003, i mungonte paanshmëria. Ai theksoi faktin se apelimi i tij i datës 9 nëntor 2001 ndaj Gjykatës së Lartë nuk u shqyrtua kurrë.

113. Gjithashtu, ankuesi pretendonte për shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 6 § 3 (a) dhe (d). Ai u ankua se nuk ishte njoftuar siç duhet për akuzat kundër tij dhe se avokatit të tij nuk iu dha mjaftueshëm kohë për të studiuar dosjen e hetimit. Ai nuk kishte akses në të gjitha dokumentet në dosje dhe veçanërisht, në deklaratën e A.L. të datës 8 maj 2001. Nuk u caktua asnjë avokat *ex officio* për ta mbrojtur atë në seancën dëgjimore të datës 29 tetor 2001, kur M. dha dëshminë e tij në procesin gjyqësor. Gjykatat vendase e kishin ndryshuar riklasifikimin e akuzave pa i dhënë mundësinë të bënte komente mbi to. Gjykata e Apelit shqyrtoi dhe hodhi poshtë apelimin e tij të datës 29 tetor 2001 në mungesë të tij. Deklarata e dëshmitarit Ç. u sigurua me nxitim, pa i dhënë ankuesit kohën e nevojshme ta rishqyrtonte atë dëshmi dhe të dorëzonte komentet përkatëse. Kërkesat e tij për raporte shtesë nga ekspertët dhe dëshmitarë të tjerë në procesin gjyqësor u hodhën poshtë pa të drejtë.

114. Neni 6 §§ 1 dhe 3 (a) dhe (d) interpretohen si më poshtë:

"1. Në përcaktimin e … çdo akuze penale kundër tij, çdo njeri ka të drejtën për një seancë dëgjimore … të drejtë … nga (një) tribunali …"

3. Çdo njeri i akuzuar për një krim ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet me përpikëri, në një gjuhë që ai e kupton dhe me detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij;

b) të ketë kohën dhe mjetet e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij;

c) ta mbrojë vetveten personalisht ose me anë të ndihmës ligjore të zgjedhur nga vetë ai, ose nëse nuk ka mjetet e nevojshme të paguajë për asistencë ligjore, kjo e fundit t'i ofrohet falas kur e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të shqyrtojë apo të ketë shqyrtuar provat kundër tij, si edhe të ndjekë dhe shqyrtojë dëshmitë në interes të tij në të njëjtat kushte, si edhe dëshmitë kundër tij."

A. Pranueshmëria

115. Qeveria parashtroi se pakënaqësitë e ankuesit për riklasifikimin e akuzave penale duhej të hidhen poshtë ose për mungesë shfrytëzimi të kompensimeve vendase ose për faktin se janë të pabaza.

116. Gjykata përsërit se ankuesit janë të detyruar të shfrytëzojnë kompensimet vendase, të cilat janë të disponueshme në teori dhe në praktikë, në kohën përkatëse, të cilat ata mund t'i krijojnë vetë – që do të thotë, kompensimet, që janë të arritshme, mund të ndihmojnë për sa u përket ankesave të tyre, si edhe të ofrojnë perspektiva për sukses (shiko, për shembull, *Sejdovic kundër Italisë*, nr. 56581/00, § 46, 1 mars 2006).

117. Në këtë rast, Gjykata vëren se J.M., njëri nga të bashkëpaditurit, apeloi pa pasur sukses në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, për riklasifikimin, e pretenduar të ishte i paligjshëm, të akuzave penale (shiko paragrafët 82 dhe 94 më sipër). Në lidhje me fatin e apelimit të të bashkëpandehurit të tij, Gjykata mendon se e njëjta ankesë e shprehur nga ankuesi nuk do të kishte pasur perspektiva të arsyeshme për sukses (shiko, gjithashtu, *Laska dhe Lika kundër Shqipërisë*, nr.12351/04 dhe 17605/04, § 47, 20 prill 2010). Për këtë arsye, gjykata e rrëzon këtë kundërshtim. Ajo nuk mendon se kjo ankesë është e pabazë apo e paranueshme në çdo këndvështrim. Prandaj, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

118. Në lidhje me pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për padrejtësi, Gjykata mendon se ato nuk janë të pabaza, në bazë të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Duke qenë se nuk janë të papranueshme, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Cilësitë

1. Bindjet e palëve

a) Ankuesi

119. Ankuesi pretendon se nuk është njoftuar me përpikëri për akuzat kundër tij. Ai nuk pati kohën e duhur të studionte dosjen voluminoze të çështjes, e cila i ishte dorëzuar në procesin gjyqësor. Disa të dhëna, si për shembull, deklarata e A.L. e datës 8 maj 2001, nuk iu dorëzua. Gjykata kishte pranuar fakte të paligjshme, si për shembull, deklaratat e dëshmitarëve Ç. dhe M. Ligji vendas përfshinte marrjen dhe pranimin e të dhënave nga lidhja me video e dëshmitarit M., të cilit i ishte bërë presion nga autoritetet të dëshmonte në shkëmbim të përjashtimit të tij nga përgjegjësitë penale. Disa nga kërkesat e tij për masa procedurale ishin kundërshtuar nga gjykata pa asnjë arsye. Duke mos mundur të caktonte një avokat *ex officio*, gjykata nuk i siguroi të drejtën e mbrojtjes në seancën dëgjimore të 29 tetorit 2001, në të cilën M. u dëgjua me anë të një lidhje me video. Edhe kjo ishte pranuar nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj të datës 14 shkurt 2003.

120. Asnjë nga dëshmitarët, të cilët dëshmuan përpara gjykatës, nuk e kishte akuzuar për pjesëmarrje në krim. Gjatë gjithë procedurave, ankuesi pohoi pafajësinë e tij. Prokurori nuk pretendoi asnjëherë se ishte në dijeni të lëvizjeve të njerëzve të tjerë të përfshirë në realizimin e krimit. Gjykatat vendase nuk kishin dhënë arsye të përshtatshme për përfundimin e tyre se ankuesi kishte kërkuar hakmarrje kundër deputetit. Deri në arrestimin e tij, ankuesi vazhdoi të punonte si anëtar i stafit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke shërbyer në policinë e trafikut.

121. Ankuesi pohoi se kishte dorëzuar një apelim kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, të datës 29 tetor 2001, siç edhe konfirmohet nga data dhe vula në apelim. Zyra e regjistrimit të Gjykatës së Rrethit ishte e detyruar ta transmetonte apelimin te zyra e regjistrimit të Gjykatës së Apelit, sipas nenit 407 § 5 të KPP-së. Nëse apelimi i tij do të ishte dorëzuar në shkelje me nenin 413 § 1 të KPP-së, Gjykata e Lartë do të duhej të kishte marrë një vendim në përputhje me nenet 112 § 1 dhe 433 § 2 të KPP-së.

b) Qeveria

122. Qeveria pretendon se ankuesi u informua me përpikëri dhe në mënyrën e duhur për akuzat që rëndonin mbi të. Kërkesa e avokatit të tij për më shumë kohë për të studiuar padinë, u përmbush nga gjykata. Ndërsa një nga disa kërkesat e tij u përmbushën nga gjykatat vendase, kërkesa për realizimin e raporteve eksperte u kundërshtua, sepse përfshirja e tij në krim as që nuk vihej në dyshim. Rrëfimet e dëshmitarëve Ç. dhe M. u përvetësuan në përputhje me ligjin vendas. Ankuesi u largua nga salla e seancës dëgjimore, më 29 tetor 2001, vullnetarisht dhe pohoi se "asnjë nuk guxon të marrë përsipër mbrojtjen time". Si përgjigje të kërkesës së gjykatës për të siguruar një avokat *ex officio*, Shoqata Shqiptare e Avokatisë nuk e kishte të mundur ta përmbushte kërkesën, duke pasur parasysh kufizimet e parashtruara nga nenet 49 § 6 dhe 51 § 1 të KPP-së. I përballur me këto kufizime dhe detyrimin për të realizuar një proces gjyqësor brenda një afati kohor të arsyeshëm, gjykata vendosi të procedonte me seancën dëgjimore.

123. Pakënaqësitë e ankuesit kishin të bënin me vlerësimin e të dhënave, çka i përkiste gjykatave vendase. Ai vlerësim nuk përmbante elemente të arbitraritetit apo të paarsyeshmërisë për sa ka të bëjë me dënimin e

ankuesit. Gjykatat vendase kishin para tyre mjaftueshëm të dhëna, të cilat konfirmonin përfshirjen e ankuesit në realizimin e krimit.

124. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, apelimi i ankuesit në Gjykatën e Lartë nuk përputhej me kërkesat e nenit 413 § 1, sepse ai ishte dorëzuar në zyrën e regjistrimit të Gjykatës së Rrethit, në vend që të dorëzohej në zyrën e regjistrimit të Gjykatës së Apelit. Ndërsa gjykata e rrethit nuk kishte asnjë detyrim t'ia transmetonte apelimin Gjykatës së Apelit, në përputhje me nenin 415 § 1 të KPP-së, apelimi ishte dorëzuar jashtë afatit kohor të përcaktuar. Ky fakt shpjegon se përse nuk iu transmetua apelimi i ankuesit Gjykatës së Lartë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

125. Duke qenë se garancitë në paragrafin 3 të nenit 6 janë aspekte specifike të së drejtës për një proces gjyqësor të drejtë, siç parashikohet edhe në paragrafin 1, Gjykata do të shqyrtojë pakënaqësitë e ankuesit, në përputhje me të dy parashikimet të marra së bashku (shiko, *inter alia*, *A.S. kundër Finlandës*, nr. 40156/07, § 47, 28 shtator 2010).

126. Gjykata thekson se ndikimi i nenit 6 § 1 është, *inter alia*, për ta vendosur një "tribunal" përpara përgjegjësisë të realizojë shqyrtimin e duhur të materialeve, argumenteve dhe të dhënave të parashtruara, pa pasur paragjykime për vlerësimin e tyre, apo nëse ato janë të përshtatshme për vendimin e saj, duke pasur parasysh se Gjykata nuk mblidhet për të shqyrtuar nëse argumentet janë shqyrtuar në mënyrën e duhur (shiko *Perez kundër Francës*, nr. 47287/99, § 80, GJEDNJ 2004-I, dhe *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, § 63, 24 maj 2005). Megjithëse neni 6 § 1 kërkon nga gjykatat që ato të japin arsye për vendimet e tyre, kjo nuk do të thotë se duhet dhënë një përgjigje e detajuar për çdo argument (shiko *Van de Hurk kundër Holandës*, 19 prill 1994, § 59, seria A, nr. 288, dhe *Burg kundër Francës* (vend.), nr. 34763/02, GJEDNJ 2003-II). Shtrirja e kësaj përgjegjësie për të dhënë arsye mund të variojë sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet sipas rrethanave të çështjes (shiko *Ruiz Torija kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994, § 29, seria A nr. 303-A, dhe *Helle kundër Finlandës*, 19 dhjetor 1997, § 55, *raportet për gjykimet dhe vendimet* 1997-VIII).

127. Parashikimet e paragrafit 3 (a) të nenit 6 përqendrohen te nevoja për vëmendje të veçantë ndaj njoftimit për "akuza" ndaj të pandehurit. Detajet e krimit luajnë një rol të rëndësishëm në procesin penal, duke qenë se nga momenti i paraqitjes së tyre, i dyshuari njoftohet me shkrim për bazën faktike dhe ligjore të akuzave kundër tij (shiko *Kamasinski kundër Austrisë*, vendim i datës 19 dhjetor 1989, seria A, nr. 168, p. 36-37, § 79). Neni 6 § 3 (a) i Konventës i jep të pandehurit të drejtën të informohet jo vetëm për shkakun e akuzave, që do të thotë për veprimet të cilat pretendohen të jenë kryer nga ai dhe mbi të cilat bazohet akuza, por edhe për cilësinë ligjore të atyre akteve. Ky informacion duhet të jetë i detajuar (shiko *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, [GJP], nr. 25444/94, § 51, GJEDNJ 1999-II). Gjithashtu, objekti dhe qëllimi i nenit 6 §§ 1 dhe 3 tregojnë se një person i akuzuar për një krim "ka të drejtën të marrë pjesë në një seancë dëgjimore dhe të dëgjohet" në praninë e tij nga një "tribunal" (shiko, midis të tjerave, *Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, 6 dhjetor 1988, §§ 68 dhe 78, seria A nr. 146).

128. Ndërsa neni 6 garanton të drejtën për një seancë dëgjimore, ai nuk anashkalon ndonjë nga rregullat për pranueshmërinë e të dhënave si të tilla, çka kryesisht është një çështje për t'u marrë parasysh nga ligji vendas (shiko *Schenk kundër Zvicrës*, 12 korrik 1988, §§ 45-46, seria A, nr. 140; *Teixeira de Castro kundër Portugalisë*, 9 qershor 1998, § 34, raportet 1998-IV; dhe *Jalloh kundër Gjermanisë*, [GJP], nr. 54810/00, §§ 94-96, GJEDNJ 2006-IX). Për këtë arsye, nuk është roli i Gjykatës të përcaktojë, për çështje parimi, nëse lloje të caktuara faktesh, për shembull, marrja e fakteve në mënyrë të paligjshme – mund të jenë të pranueshme. Pyetja së cilës mund t'i përgjigjemi është nëse procedurat në total, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë siguruar faktet, ishin të drejta (shiko, midis autoriteteve të tjera, *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35394/97, § 34, GJEDNJ 2000-V; *P.G. dhe J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 44787/98, § 76, GJEDNJ 2001-IX; *Bykov kundër Rusisë*, [GJP], nr. 4378/02, § 89, GJEDNJ 2009-…; dhe *Gäfgen kundër Gjermanisë* [GJP], nr. 22978/05, §163, GJEDNJ 2010-…).

129. Në përcaktimin nëse procedurat në tërësi ishin të drejta, duhej t'i ishte kushtuar vëmendje nëse ishin respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në veçanti, duhet shqyrtuar nëse ankuesit i është dhënë mundësia të kundërshtonte vërtetësinë e fakteve dhe përdorimin e tyre (shiko *Gäfgen*, të cituar më sipër, § 164). Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë cilësia e të dhënave, duke përfshirë nëse rrethanat në të cilat ato u morën hedhin dyshime mbi besueshmërinë dhe saktësinë e tyre. Ndërkohë që nuk ngrihet asnjë problem drejtësie nëse faktet e marra ishin të pambështetura nga materiale të tjera, mund të vihet re se aty ku të dhënat janë shumë të forta, nuk kanë rrezik të jenë të pabesueshme dhe nevoja për të dhëna mbështetëse është më e vogël (shiko, *mutatis mutandis*, *Khan*, §§ 35 dhe 37, *Allan*, § 43, dhe *Bykov*, § 90, të gjithë të cituar më sipër).

130. Gjykata do të shqyrtojë me radhë arsyet për pakënaqësitë e ankuesit, sipas kërkesës së përgjithshme për drejtësi të nenit 6 të Konventës.

a) Shpallja e akuzës

131. Gjykata shpjegon se ankuesi u arrestua më 22 janar 2001. Urdhri i arrestit përcakton qartë akuzat penale që ngrihen kundër tij. Më 23 janar 2001, ankuesi u informua plotësisht për akuzat kur u pyet nga prokurori. Në seancën dëgjimore të datës 24 janar 2001, për miratimin e arrestimit të tij dhe në prani të avokatit të zgjedhur prej tij, ai bëri deklarata në lidhje me akuzat dhe ngjarjet që u përmendën. Për këtë arsye, gjykata mendon se ankuesi është njoftuar në mënyrën e duhur për akuzat kundër tij. Ajo shpjegon se bërja me dije për akuzën nuk duhet të pasohet nga shpallja e të dhënave mbështetëse, në mënyrë që i pandehuri të përgatitet për procesin gjyqësor (shiko *Brozicek kundër Italisë*, 19 dhjetor 1989, § 42, seria A nr. 167). Ekzistenca e fakteve të tilla mund të varet nga rezultatet e hetimit në vijimësi.

b) Organizimi i procedurave gjyqësore

i) Parashikimi i kohës së duhur

132. Pas njohjes me padinë, më 13 mars 2001, avokati i ankuesit pati mundësinë për të përdorur dosjen voluminoze të hetimit deri më 16 mars 2001. Në seancën dëgjimore më 3 prill 2001, gjykata pranoi kërkesën e avokatit për të zgjatur kohën e nevojshme për të shqyrtuar dosjen e çështjes. Në dosjen e çështjes nuk ka asnjë tregues se ankuesi kërkonte kohë shtesë.

ii) Ndjekja e seancave dëgjimore në procesin gjyqësor

133. Gjykata kujton se as letra dhe as natyra e nenit 6 të Konventës nuk e pengon personin të heq dorë me vullnetin e tij të lirë, qoftë në formën e shprehur qartësisht me fjalë ose me nënkuptime, nga e drejta që i garanton një proces gjyqësor të drejtë. Megjithatë, nëse bëhet efektive për arsye të Konventës, një dorëheqje e tillë ndërmerret në mënyrë të padyshimtë dhe shoqërohet nga minimumi i rojeve të sigurisë në përpjesëtim me rëndësinë e saj (shiko *Hermi kundër Italisë* [GJP], nr. 18114/02, § 73, GJEDNJ 2006-XII). Në këto rrethana, Gjykata shpjegon se ankuesi në mënyrë të padyshimtë dhe të lirë hoqi dorë nga e drejta e tij për të ndjekur seancën dëgjimore të datës 29 tetor 2001 ose për t'u përfaqësuar nga një avokat *ex officio*, në kohën kur M. u dëgjua me anë të një lidhje me video; ndërkohë avokati i zgjedhur prej tij u ndalua të ndiqte atë seancë dëgjimore.

iii) Marrja në pyetje e dëshmitarëve

134. Për sa ka të bëjë me parregullsitë e pretenduara në lidhje me pranimin e dëshmisë së Ç. dhe M., Gjykata shpjegon se gjykatat vendase i hodhën poshtë ato dëshmi si kontradiktore dhe me mungesë në besueshmëri, dhe nuk u bazuan në to.

135. Rezulton se deklarata e A.L., e datës 8 maj 2001, fillimisht nuk u paraqit para mbrojtjes. Megjithatë, çdo padrejtësi e shkaktuar nga ky veprim u shlye nga gjykata, e cila u sigurua që A.L. të dëshmonte. Ankuesi dhe avokati i tij ndoqën seancën dëgjimore, e ripyetën A.L dhe kundërshtuan ta përdornin dëshminë e tij.

iv) Përfaqësimi nga një avokat

136. Në të gjitha fazat e procesit gjyqësor, ankuesi u përfaqësua nga një avokat, i zgjedhur prej tij, ndoqi pothuajse të gjitha seancat dëgjimore të lidhura me çështjen, pati mundësinë të dorëzonte fakte dhe të merrte në pyetje një sërë dëshmitarësh.

c) Organizimi i procedurave të apelit

i) Riklasifikimi i krimit

137. Gjatë vlerësimit të drejtësisë së ushtruar në tërësinë e procedurave penale, Gjykata pranoi se riklasifikimi i një krimi nuk shkelte të drejtat e mbrojtjes, nëse i pandehuri ka pasur mjaftueshëm mundësi të mbrojë veten, gjatë procedurave të rishqyrtimit (shiko *Dallos kundër Hungarisë*, nr. 29082/95, §§ 47-53, 1 mars 2001; dhe *Sipavičius kundër Lithuanisë*, nr. 49093/99, § 30, 21 shkurt 2002). Në çështjen konkrete, ankuesi e kundërshtoi dënimin e tij dhe riklasifikimin, përpara Gjykatës së Apelit, gjykatë, e cila është kompetente për t'u marrë me këtë çështje. Edhe Gjykata e Lartë shqyrtoi apelimin e ankuesit kundër dënimit të tij, me arsyen për të riformuluar akuzën. Gjithashtu, ajo shqyrtoi edhe apelimin e të bashkëpandehurve të tij në lidhje me riklasifikimin e krimit. Ajo gjykatë ishte në gjendje t'i ofronte lehtësim të ankuarit dhe bashkëtëpandehurit të tij (shiko paragrafin 89 më sipër), por mbi baza të arsyeshme, ajo i kundërshtoi kërkesat e paraqitura.

138. Prandaj, Gjykata mendon se duke pasur parasysh faktet e çështjes, veçanërisht materialet e paraqitura së fundmi nga prokurori në procesin gjyqësor, siç parashtrohet edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit (shiko paragrafin 70 më sipër), nuk mund të thuhet se ankuesi nuk mund ta studionte riklasifikimin e akuzës penale kundër tij. Ankuesi pati kohën dhe lehtësirat e duhura, për të përgatitur mbrojtjen e tij ndaj akuzës së

riformuluar dhe, në fakt, ai e paraqiti përpara Gjykatës së Apelit mbrojtjen e tij për akuzën e riformuluar. Në këtë këndvështrim, kjo çështje dallon nga çështja *Pélissier dhe Sassi*, ku Gjykata e Kasacionit nuk e rishqyrtoi "maturinë" e Gjykatës së Apelit në riklasifikimin e akuzës.

ii) Pamundësia e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar apleimin interlokutor të ankuesit, më 9 nëntor 2001, në lidhje me mungesës e paanshmërisë së Gjykatës së Rrethit

139. Nga dokumentet në dosjen e çështjes rezulton se më 9 nëntor 2001, ankuesi dorëzoi një apelim interlokutor kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, të datës 29 tetor 2001. Apelimi ishte dorëzuar në zyrën e regjistrimit të Gjykatës së Rrethit. Më 14 janar 2002, ankuesi i kërkoi Gjykatës së Rrethit të merrte informacion në lidhje me fatin e këtij apelimi. Ai u informua se Gjykata e Lartë nuk kishte kërkuar transferimin e dosjes së çështjes për shqyrtim.

140. Më 5 gusht 2002, ankuesi e ngriti këtë pakënaqësi në Gjykatën e Lartë në apelin kundër dënimit të tij. Më 14 shkurt 2003, Gjykata e Lartë pranoi se kishte një kopje të apelimit të ankuesit, të datës 9 nëntor 2001, në dosjen e çështjes, por apelimi nuk përputhej me kërkesat përkatëse ligjore.

141. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se mos shqyrtimi i apelimit interlokutor të ankuesit, i datës 9 nëntor 2001, i ishte dorëzuar Gjykatës së Lartë më 5 gusht 2002, e cila, megjithëse me vonesë, e shqyrtoi atë dhe konstatoi se nuk plotësonte kërkesat e nevojshme ligjore. Për më tepër, nën dritën e të gjitha materialeve në zotërim, Gjykata konstaton se nuk ka asnjë shenjë të paanshmërisë nga ana e bankës së Gjykatës së Rrethit.

iii) Parashikimi i arsyeve të duhura (adekuate)

142. Dënimi i ankuesit u bazua në deponimet e dëshmitarëve A.L, K.G. dhe J.M., edhe pse asnjëri prej tyre nuk e akuzoi ankuesin drejtpërsëdrejti për goditjet me armë, gjykatat vendase arsyetuan se, në bazë të atyre deponimeve, por edhe bazuar në të dhënat e mbledhura nga rrethanat, provohet pjesëmarrja në krim e ankuesit në rolin e ndihmësit (shiko paragrafët 69, 72 dhe 80 më sipër). Gjykata kujton se përdorimi i të dhënave indirekte apo rrethanore nuk përjashtohet nga neni 6 (shiko, për shembull, *Cesky dhe Koti kundër Republikës Çeke* (vend.), nr. 76800/01, 76801/01, 7 prill 2009; *Alberti kundër Italisë*, nr. 12013/86, vendim i Komisionit i datës 10 mars 1989; dhe, *mutatis mutandis, Andandonskiy kundër Rusisë*, nr. 24015/02, § 52, 28 shtator 2006).

143. Gjykata e Apelit rihapi shqyrtimin gjyqësor dhe plotësoi disa nga kërkesat e ankuesit, por kundërshtoi pjesën e mbetur të tyre. Kështu, Gjykata vëren se gjykatat vendase e vlerësojnë maturinë për sa ka të bëjë me pranimin e të dhënave. Atyre nuk mund t'iu referohemi për kundërshtim të kërkesave të ankuesit, nëse ato kanë gjykuar se kanë pasur mjaftueshëm të dhëna për të gjykuar këtë çështje.

144. Mund të argumentohet se të tjera masa hetuese ishin të nevojshme për të provuar fajësinë e ankuesit. Megjithatë, Gjykata nuk mund të spekulonte për përfundimet e procesit gjyqësor në këtë aspekt. Është e sigurt se grupi i të dhënave kundër ankuesit u bë subjekt i procedurave kundërshtuese, të cilat garantonin respekt për të drejtat e mbrojtjes në çdo fazë të procedurave të apelimit.

d) Përfundim

145. Duke pasur parasysh pikat e mësipërme, Gjykata mendon se procedurat vendase, të para në tërësi, nuk shfaqin ndonjë element të padrejtësisë procedurale. Për këtë arsye nuk ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri në (d) të Konventës.

III. PRETENDIME PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 2 TË KONVENTËS

146. Ankuesi shprehu pakënaqësinë se dëshmia e ministrit të Drejtësisë së asaj kohe, i cili la të kuptohej se ankuesi ishte fajtor, theu mundësinë për pafajësi, siç garantohej nga neni 6 § 2 i Konventës. Për më tepër, gjykatat vendase e konsideruan atë fajtor bazuar në deponimet e dëshmitarëve M. dhe A.L., të cilat u konsideruan kontradiktore dhe të pabesueshme. Neni 6 § 2 i Konventës interpretohet si më poshtë:

"2. Çdo individ i akuzuar për një krim, presupozohet të jetë i pafajshëm deri sa të provohet që është fajtor sipas ligjit."

147. Qeveria parashtroi idenë se kjo ankesë duhet të kundërshtohet për mospërdorim të kompensimeve vendase.

148. Gjykata i referohet parimit të përgjithshëm në paragrafin 116 më sipër, i cili ka të bëjë me kërkesën për përdorimin e lehtësirave vendase.

149. Pasi shqyrtoi apelimin e ankuesit, Gjykata vëren se ankuesi nuk e paraqiti ankesën e tij, të paktën në substancë, përpara gjykatave vendase. Për këtë arsye, ajo kundërshton pakënaqësinë e ankuesit për mos shfrytëzim të kompensimeve vendase në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

IV. PRETENDIME PËR SHKELJE TË NENIT 7 TË KONVENTËS

150. Ankuesi shprehu pakënaqësinë, sipas nenit 7 të Konventës, se ai ishte dënuar në bazë të një parashikimi penal, i cili nuk ekzistonte në kohën kur u krye krimi. Neni 7 pohon si më poshtë:

"1. Asnjë nuk do të shpallet fajtor për kryerjen e një krimi, nëse ka të bëjë me një veprim apo përjashtim, të cilët nuk përbëjnë krim sipas ligjit vendas apo të huaj, në kohën kur ai është kryer. Gjithashtu, nuk do të jepen dënime më të rënda se sa ato që janë

në fuqi në kohën kur ndodh krimi.

2. Ky nen nuk paragjykon as procesin gjyqësor dhe as dënimin e një personi për çdo akt, i cili në kohën kur është kryer ishte penal sipas parimeve të përgjithshme të ligjit të njohur nga kombet civile."

151. Gjykata kërkoi që kjo ankesë të kundërshtohej për mosshfrytëzim të kompensimeve vendase.

152. Pasi shqyrtoi apelimet e ankuesit, Gjykata vëren se ankuesi nuk e ngriti pakënaqësinë e tij, të paktën në substancë, përpara gjykatave vendase. Prandaj ajo kundërshton ankesën e ankuesit për mosshfrytëzim të kompensimeve vendase në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA

1. Në mënyrë unanime, i *deklaron ankesat* sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri në (d), për sa ka të bëjë me pretendimin për padrejtësi procedurale të procedurave, të pranueshme dhe pjesën e mbetur të aplikimit të papranueshëm;

2. *Vendos*, me numër votash gjashtë me një, se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri në (d) të Konventës.

E hartuar në anglisht dhe e mbajtur me shkrim, më 8 tetor 2013, sipas nenit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Françoise Elens-Passos — SEKRETARE

Ineta Ziemele — PRESIDENTE

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe rregulli 74 § 2 i rregullores së Gjykatës, opinioni i veçantë i gjykatësit De Gaetano, është aneksuar në këtë vendim.

I.Z.

F.E.P.

VENDIMI HAXHIA KUNDËR SHQIPËRISË – OPINIONE TË VEÇANTA

OPINIONI PJESËRISHT KONTRADIKTOR I GJYKATËSIT DE GAETANO

1. Më vjen keq që në këtë çështje unë nuk ndaj opinionin e shumicës, e cila pretendon se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1.

2. Çështja kundër ankuesit u mbështet tërësisht në të dhënat rrethanore. Është i rëndomtë fakti se të dhënat rrethanore nuk gënjejnë, por mund të mashtrojnë. Gjithashtu, në përgjithësi, dihet se të dhënat rrethanore funksionojnë ku janë të gjitha bashkë, në progresion gjeometrik, duke eliminuar mundësitë e tjera. Për këtë arsye, ato nuk duhet të interpretohen vetëm në mënyrë të ngushtë, por edhe të shqyrtohen imtësisht. Për më tepër, në çështjen në fjalë, ankuesi nuk është akuzuar si drejtuesi, por si ndihmësi ose bashkëpunëtori. Prandaj, pika kritike ishte nëse mund të tregohej se të dhënat rrethanore përcaktonin në mënyrë të përmbledhur ekzistencën e një plani të përbashkët – *idem placitum consensus* – midis ankuesit dhe drejtuesit apo drejtuesve.

3. Edhe pse kjo çështje ligjore e Gjykatës, në përputhje me nenin 6, ka përsëritur vazhdimisht se nuk është një gjykatë e shkallës së katërt për rishqyrtimin e fakteve të çështjes, ajo shprehet se edhe pse një vendim mund të mos jetë arbitrar për shkak të mungesës së plotë të arsyeve, përsëri, ajo mund të mos ketë mjaftueshëm arsye sipas rrethanave të caktuara të çështjes, dhe për pasojë mund të shkelë nenin 6 § 1. Kështu, kur një koncepti ligjor i mungon precizioni, çka përfshin një vlerësim të pyetjeve rreth fakteve; një gjykate mund t'i kërkohet të japë më shumë arsye të detajuara, veçanërisht nëse përfundimi ka një natyrë vendimtare (shiko, midis të tjerëve, *Georgiadis kundër Greqisë*, nr. 21522/93, 29 maj 1997, në veçanti § 43). Po kështu, një gjykatë, edhe pse mund të japë arsye, mund t'i shmangë vështirësitë e çështjes (*Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 184/02, 11 janar 2007, § 84); ose gjykata vendase mund të injorojë një pikë "të caktuar", të rëndësishme lidhur me çështjen *(Pronina kundër Ukrainës*, nr. 63566/00, 18 korrik 2006), edhe nëse arsyet janë dhe në përputhje me të tjera çështje.

4. Unë nuk gjej asnjë gjë në vendimin madhor, që të tregojë, ose të paktën të sugjerojë, se u dhanë mjaftueshëm arsye nga Gjykata e Rrethit apo nga Gjykata e Apelit, për të mbështetur faktet e tyre për një plan të përbashkët, midis ankuesit dhe drejtuesit apo drejtuesve (Gjykata e Lartë nuk pranoi të shqyrtojë ankesën të lidhur me mungesën e arsyeve adekuate, duke qenë se nuk ishin në kompetencën e saj, shiko § 91). Përkundrazi, kjo çështje kritike për një plan të përbashkët nuk i përkiste këtyre dy gjykatave. Vetëm kjo, mund të mjaftojë si element që dhunon nenin 6 § 1.

5. Por ka edhe më shumë. Çështja e ankuesit ishte e një profili të lartë kundër një skene trazirash politike. Mendimi praktik do të donte që gjykatat që merren me procedurat juridike, në të tilla rrethana, do të bënin

mjaft kujdes, për të mos krijuar asnjë hije dyshimi për procedurat përkatëse. Përkundrazi, në rastin tonë konkret, apelimi i ankuesit në Gjykatën e Lartë për vendimin e Gjykatës së Apelit, më 29 tetor 2001 (për pretendimin për mungesë paanshmërie nga ana e gjykatës së rrethit) nuk u shqyrtua kurrë nga kjo Gjykatë e Lartë, duke krijuar në dukje një gabim administrativ (shiko §§ 75-77, 87, 121 dhe 124). Apelimi i ankuesit në Gjykatën e Apelit duket të jetë zgjidhur me zell të madh (shiko në veçanti §§ 79-80). Apelimi në Gjykatën Kushtetuese u deklarua i papranueshëm pa dhënë asnjë arsye. Kështu, mbetet ende dyshim.

4. Për të gjitha këto arsye, sipas këndvështrimit tim, ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1.